



Titulli i projektit

Rikonstruksioni i lulishtes "Dardania", Bajram Curri

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik/ Shërbime Publike/ Projekte që mobilizohen shpejt

Vendndodhja e projektit

Bashkia Bajram Curri

Buxheti i paravlerësuar

80,000 EUR

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Qyteti i Bajram Currit ka një popullsi prej 5340 banorësh, të ndarë në tre lagje, përkatësisht "28 Gushti", "Dardania" dhe "Partizani". Lagjia "Dardania" është e pozicionuar në verilindje dhe juglindje të qytetit Bajram Curri. Ajo ka rreth 3350 banorë dhe rreth 800 familje. Në këtë lagje mungojnë kushtet për një jetë të përshtatshme dhe të kulturur në komunitet. Në një sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup>, banorët nuk gëzojnë një mjedis sipas standardeve, pasi hapësirat publike janë në gjendje jo të përshtatshme për shkak të mungesës së buxheteve për mirëmbajtjen e tyre. Aktualisht, ka një mungesë të hapësirave të gjelbërta dhe rrugëve midis pallateve. Po ashtu, trotualet dhe ndriçimi mungojnë. Në këtë lagje është rritur vazhdimisht edhe nevoja e vendeve të parkimit, të cilat më parë nuk janë konsideruar si mjedise të nevojshme për komunitetin. Banorët e kësaj lagjeje dhe sidomos fëmijët dhe të moshuarit, nuk kanë vende të mjaftueshme për t'u çlodhur dhe argëtuar. Kryesisht, për fëmijët janë të pamjaftueshme këndet e lojrave dhe hapësirat për të kaluar kohën e lirë dhe pa u rrezikuar. Ka një kënd lojërash të ndërtuar në vitin 2010, por shumë i vogël. Investimet e mëparshme në këtë lagje janë të pakta. Projekti është në përputhje me studimin e zonës funksionale Tropojë përsa i përket përmirësimit të kohezionit social të komunitetit.

Qëllimi/et specifik të projektit

Objektivat specifikë përfshijnë:

1. Përmirësimi kushteve të komunitetit për çlodhje dhe argëtim në lagjen "Dardania", qyteti Bajram Curri.
2. Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e ambienteve publike

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme të projektit përfshijnë:

1. Rritja e sipërfaqeve të gjelbërta;
  2. Krijimi i mjediseve të përshtatshme për lëvizjen e banorëve, ndriçimin dhe parkimin e automjeteve;
  3. Rritja e sipërfaqeve çlodhëse për banorët,
  4. Komuniteti i ndërgjegjësuar për mirëmbajtjen e investimit të kryer.
- Numri i popullsisë përfutuese: rreth 3350 banorë të qytetit Bajram Curri (rreth 40 % e popullsisë së qytetit Bajram Curri).

# PROJEKTI 10



program i zonave funksionale

# pzf

## Aktivitetet e projektit

Aktivitetet kryesore të projektit përfshijnë:

1. Sistemimi i terrenit në një sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup>;
2. Ndërtimi i trotuareve;
3. Ndriçimi i lagjeve;
4. Ndërtimi i këndeve të lodrave dhe vendosja e stolave;
5. Sistemimi i vendit të parkimit;
6. Krijimi i sipërfaqeve të gjelbërta;
7. Ndërgjegjësimi i komunitetit për mirëmbajtjen e investimit të kryer.

Afati i përfundimit të projektit është 6 muaj

## Maturimi i projektit

Propozimi përfshihet në funksionet e drejtpërdrejta të Bashkisë Tropojë. Ky propozim është në fazën e një projekt-ideje.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Projekti do të realizohet nga Bashkia Tropojë.

Financuesit e projektit përfshijnë: Bashkia, komuniteti, biznesi, donatorë vendas dhe të huaj.

## Kostot e projektit

Kostoja totale e projektit është afërsisht 80,000 Euro.